



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 272/2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga Muhamet Rexha, kryesues, Rafet Haxhaj dhe Nehat Idrizi, anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën, e Arsim Janova, Kryetar i Shtabit Zgjedhor të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dega në Rahovec, që ka të bëjë me shkeljen e Rregullës Nr.11/2009-Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, në seancën e mbajtur me datë 22.11.2010 mori këtë:

VENDIM

REFUZOHET Ankesa si e pabazuar.

ARSYETIMI

Z. Arsim Janova, Kryetar i Shtabit Zgjedhor të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dega në Rahovec ka parashtruar Ankesë kundër subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), e cila ka bërë shkeljen e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kosovës neni 33 pika (a) dhe Rregullës Zgjedhore “Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët” NR.11/2009 neni 3.1 pika (a), duke bërë Veprime të Ndaluar, ku më datë 16.11.2010 ora 16:00 në rrugën “Xhelal Hajda“- Toni aktivistët e AKR-së kanë mbuluar posterin e kandidatit për Kryetar Komune të Rahovecit nga radhët e LDK-së Z. Ibrahim Kryeziu me atë të kandidatit të mundshëm për Kryetar Komune nga radhët e AKR-së Z.Rexhep Oruçi.

FAKTET

Më 17 nëntor 2010, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) ka pranuar një ankesë që i ishte dorëzuar nga Z.Arsim Janova, kryetar i shtabit zgjedhor të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), duke pretenduar se subjekti politik AKR, ka bërë shkeljen e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kosovës neni 33 pika (b) dhe Rregullës Zgjedhore “Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët” NR.11/2009 neni 3.1 pika (a). Më datë 16.11.2010 ora 16:00 në

rrugën “Xhelal Hajda“-Toni aktivistët e AKR-së kanë mbuluar posterin e kandidatit për Kryetar Komune të Rahovecit nga radhët e LDK-së Z. Ibrahim Kryeziu me atë të kandidatit të mundshëm për Kryetar Komune nga radhët e AKR-së Z. Rexhep Oruçi. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur një fotokopje e fotos pa-ngjyrë si dëshmi nga vendi i ngjarjes.

ANALIZË

Jurisdiksioni i PZAP-it lidhur me ankesat është caktuar në pajtim me autorizimin e dhënë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës në Ligjin Nr. 03/L-256, dhe Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës (Ligji Nr. 03/L-072).

Rregulla dhe Procedurat e PZAP-it neni 3.6 pika c parasheh:

c) hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit;

Duke i shqyrtuar faktet e paraqitura nga pala ankuese, PZAP konsideron se ankesa në fjalë ka mungesë të provave të mjaftueshme dhe të pranueshme për t’u bindur se AKR ka mbuluar posterin e kandidatit të LDK-së. Fotokopja e paraqitur si dëshmi mbështetëse për rastin në fjalë, nuk krijon mundësinë për të vërtetuar shkeljen e pretenduar, si dhe nuk shfaq qartë ekzistencën e shkeljes në bazë të Rregullës Zgjedhore “Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët” NR.11/2009 neni 3.1 pika (a).

Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

A nr. 272/2010 më datën 22.11.2009.

Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha

